

V E N D I M
Nr.158, datë 7.4.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.424, DATË 6.8.1993 “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË POLITIKËS SHKENCORE E TË ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK DHE RIORGANIZIMIN E KOMITETIT TË SHKENCËS DHE TË TEKNOLOGJISË”

Në zbatim të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, dhe të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.424, datë 6.8.1993, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 2, paragrafi i dytë, fjalët “drejton dhe bën” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “përcakton dhe drejton”.
 - b) Në pikën 2 shtohen dy paragrafë, që bëhen përkatësisht paragraf i katërt dhe i shtatë me këtë përmbajtje:
 - “ - Jep mendim për projektligjet dhe projektvendimet për veprimtarinë shkencore e teknologjike, që i paraqiten për miratim Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave”.
 - “ - Krijon komisione e grupe pune të përhershme ose të përkohshme për problemet e caktuara”.
2. Pika 3, pika 4, paragrafi 14, pika 5 dhe pika 7 shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi